Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Sahit Beqiri	**05.12.2023**	**06.12.2023**	**2023/0972**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **04.12.2023**, OE: **"Internat Security Association" SH.P.K."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0972**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: **"Rojet e Nderit" SH.P.K."- Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sigurim fizik i objekteve per nevojat e MINT"** me nr. të prokurimit: **"204-23-7170-2-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – Ministria e Industrise, Ndermarresise dhe Tregtise.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur,** lloji i kontratës: **kontratë publike kornizë - shërbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **380,000.00 €.**Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë **NUK** është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankese)

Neni 7

Neni 27

Neni 59

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet

Të Nderuar

Duke pas parasysh se ne si OE palë me interes në këtë AP, kemi ofertuar sipas kërkesave të AK për këtë AP, jemi të habitur se si AK ka shpallur fitues një kompani e cila është e papargjegjshme financiarisht, pse po e cekim këtë do ju ofrojmë argumentet si në vazhdim:

1. Dosja e tenderit dhe kërkesat e saj në ANEKS 1 për pagat e punëtorëve dhe numrin e punëtorëve të caktuar nga vetë AK, sipas këtyre kërkesave ne edhe kemi ofertuar me ofertën tonë ku kemi llogaritur pagat saktë dhe disa të drejta të dala nga ligji I punës së Republikës së Kosovës, për të cilin pretendim ne do të ofrojmë llogaritjen dhe pyetjet e bëra nga AK kundrejt nesh.

AK ka kërkuar që numri I punëtorëve të jetë 28 punëtor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit sipas kërkesës së evidentuar te ANEKS 1 specifikimet teknike të detyrueshme (shih kërkesën e AK si më poshtë).

Sqarim:

1. Shpërndarja e punëtorëve (rojeve) duhet të bëhet në koordinim me autoritetin kontraktues, përcaktimi i pikave, i numrit, i shpërndarjes së rojeve...etj.

2. Numri i Objekteve dhe/ose numri i rojeve mund të rritet apo të zvogëlohet, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktues që mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

3. Numri i përafërt i punëtorëve (rojeve) do të jetë rreth njëzet (28) persona (OE duhet të na dëshmojë kontratat e punës si dhe vërtetimin nga ATK që paguan taksat dhe kontributet për punëtoret).

4. Objekti i Industrisë Kimike, Parku i Biznesit në Drenas dhe në Z.K. Bërnicë e Epërme me lokacion në "Bardhosh", Prishtinë posedojnë rrethoja që nënkupton sigurimin e tyre (rrethojës) dhe hapësirave brenda tyre.

5. Orari i punës për punëtoret (rojet) duhet të jetë në përputhje me orarin e caktuar në Ligjin e Punës (40 orë pune në javë).

6. Në rast te humbjes apo vjedhjes së ndonjë gjësendi në kohen e siguruar nga ana e Kompanisë, kompania duhet te përgjigjet brenda 10 ditëve nga humbja apo vjedhja duke e kompensuar demin e shkaktuar.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është 30 %

Vërejtje: Pagat e punëtoreve nuk duhet të jenë më të ulta se 350.00.00 € neto. "

Këtë kërkesë AK e ka anashkaluar plotësisht dhe në mënyrë të njëasnhme duke favorizuar OE fitues edhe pse ky OE nuk e plotëson këtë kushtë fare, e për që nuk e plotëson ne do ju japim shpjegimin sakt dhe qartë në lidhje me këtë vërejtje tonë në këtë procedurë ankimore.

Ne ju kemi dërguar një analizë financiare të cilën AK e ka kërkuar përmes në letre standarde për sqarim e tenderit të datës 01.11.2023, ku wshtw kërkuar që sqarimet tona të ipen bazuar kërkesës së dosjes së tenderit respektivisht kërkesës së ANEKS 1 për pagat

“ Në kuadër të dosjes se tenderit AK-MINT ka kërkuar qe paga e nje punëtori neto nuk duhet te jet me e ulët se 350 euro, dhe orari i punës për punëtoret (rojet) duhet të jetë në përputhje me orarin e caktuar në Ligjin e Punës (40 orë pune në javë).andaj bazuar ne këto kërkesa ligjjore te specifikuara ne dosjen e tenderit dhe për të vlerësuar drejtë dhe sipas LPP-së ofertën tuaj ju duhet të bëni sqarimin se si e keni llogaritur çmimin njësi ore per puntor (kalkulimi te behet vetëm per nje punëtor) bazuar ne çmimin njësi te ofruar tek pjesa e përshkrimit te çmimit ku janë te përfshira sasia e orëve.”

Ne ju kemi dërguar analizën financiare si më poshtë :

ANALIZA FINANCIARE

AK - Ministria e Industrise Ndermarresise dhe Tregtise , BUXHETI I CAKTUAR 380000.00

PAGA E CAKTUAR NETTO	350		
KONTRIBUTI NGA PUNEDHENESI	19.27		
KONTRIBUTI NGA PUNEMARRESI	19.27		
TATIMI NE BURIM I PAGES	16.09		
TOTAL PAGA ME TE GJITHA TAKSAT PER NJE PUNETOR	404.63		
TOTAL NUMRI I PUNETOREVE TE KERKUAR	28		
TOTALI I PAGAVE PER TE GJITHE PUNETORET NE MUAJ	**11329.64**	TVSH	**TOTAL VETEM PAGAT**
TOTAL PAGA PER 24 MUAJ	**271911.36**	48944.04	**320855.40**
PUSHIME VJETORE SIPAS ORGANIZIMIT TE KOMPANISE ME TVSH	**14968.77**		
TOTAL PAGAT E 28 PUNWTORËVE TË SIGURIMIT DHE ZEVENDSIME PER PUSHIME	**286880.13**		
FITIMI I KOMPANISE PER 24 MUAJ	**415.63**		
TOTAL PAGA PUSHIME DHE FITIM	**287295.76**		
TVSH 18%	**51713.24**		
TOTAL OFERTA	**339009.00**		
GJITHSEJ ORET E EVIDENTUARA TE PERSHKRIMI I CMIMIT	**167000**		
KALKULOJME 339009.00 / 167000	**2.03**		

Siq edhe mund të shifni bazuar në analizën tonë e cila është e saktë minimum I cmimit të ofertuesve në këtë rast vetëm duke llogaritur pagat e kërkuara do të duhej të ishte në pragun e cmimit me TVSH **320855.40** euro, cmimi I ofertës sonë **339,009.00 euro mbi pragun e lejuar** , ku janë kalkuluar pagat dhe zavendesimet për pushime vjetore, atëherë si është e mundur që OE I shpallur fitues të mbulojë kërkesën e juaj financiare, kjo është diskriminuese dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimit pasi që keni bërë shkelje të kushteve për pjesmarrje në tender të OE ofertues e posaqërisht keni bërë shkelje të nenit 7 , neni 27 , nenit 59 të LPP- së. OE I shpallur fitues wshtw me ofertw afwr 20000.00 euro nën paga.

Andaj kërkojmë nga OSHP që kjo ankesw të merret e bazuar dhe AP të kthehet në rivlersim duke respektuar pragun e ofertave për pagat e punëtorëve në vlerë prej 320855.40 euro, duke I klasifikuarofertat nga ky cmim e të lartë.

Me Respekt

International Security Association sh.p.k

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues kurse, tek Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet – janë te njëjta me atë të dorëzuar në kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME – Aneks 1

Kompania e sigurimit fizik (OE) duhet të kryejë këto detyra:

Të kontrolloj në hyrje dhe dalje në objekt / hapësirë

Evidentimi i palëve (vizitorë dhe të tjerë),

Evidentimi i hyrjes dhe daljes të automjeteve,

Kompania është e Obligueshme të mbajë raportet ditore dhe javore dhe ti

dorëzoj në baza mujore Autoritetit Kontraktues

Të jenë konfidencial dhe të sigurojë objektet 24 orë,

Të startoj dhe ndal Gjeneratorin sipas nevoje,

Të posedojnë pasqyrën për kontrollimin e Automjeteve dhe të posedojnë radio lidhje,

Të posedojnë Detektor metali (dore),

Roja duhet të posedoj brezin, rrypin më shufër, pranga dhe bateri dore për çdo

roje. Rojet duhet të jenë të trajnuar për përdorimin e shufrës dhe prangave.

Uniforma e Kompanisë duhet të jetë e pastër,

Në disa prej objekteve Rojet duhet ta kryejnë edhe detyrën e recepsionistit, varësisht prej nevojës,

Kompania nuk mund të bëjë ndërrimin e rojeve pa e njoftuar Autoritetin Kontraktues 30 ditë më pare,

Asnjë punëtor i Kompanisë të Sigurimit nuk mund t'ia filloj punës pa ID të kompanisë qe

përfaqëson,

Pas nënshkrimit të Kontratës, para fillimit të punës, Kompania është e Obligueshme të dorëzoj listën e punëtorëve që do aktivizoj në cilësinë objekt si roje,

Gjithashtu Kompania duhet dorëzuar edhe emrat e mbikëqyrësve të rojeve,

Kompania duhet dorëzuar Autoritetit Kontraktues Procedurat Standarde të Sigurimit,

Bëjë pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave fizike të punës,

Pranoj dhe dorëzoj me procesverbal të plotë të nënshkruar dhe protokolluar situacionin aktual të pranim/dorëzimit të objekteve/hapësirave të lartcekura,

Është përgjegjëse për përdorimin e Aparateve për fikjen e zjarrit,

Punë tjera shtesë rreth sigurimit fizik në raste se kërkohet nga Autoriteti Kontraktues,

Kompania që bënë sigurimin e objektit mban përgjegjësi të plotë për të gjitha dëmtimet si dhe vjedhjet eventuale që mund të ndodhin gjatë sigurimit fizik të këtij objektit / hapësirës, është e obliguar që të bëjë kompensimin e tyre dhe të përgjigjet konform legjislacionit/rregulloreve në fuqi.

Objektet ekzistuese në të cilat do të ketë roje janë objektet:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – MTI Prishtinë,

Agjencioni i Metrologjisë –MTI Prishtinë,

Instituti i Metrologjisë- MTI Prizren,

Laboratori i Industrisë Kimike –Bërnicë, ka një hapësirë prej 80 ari,

Sigurimi fizik në Z.K. Bërnicë e Epërme me lokacion në "Bardhosh", Prishtinë, ka një sipërfaqe prej49544 m^2. Është i rrethuar me rrethojë. Ka Portën hyrëse-dalëse.

Sigurimi fizik në Parkun e Biznesit në Drenas

Parku i Biznesit në Drenas, ka një sipërfaqe prej 24 hektarësh dhe momentalisht 41 biznese të vendosura në këtë Park. Është i rrethuar me rrethoj. Ka Portën hyrëse-dalëse.

- Të qëndrojë në Parkun e Biznesit në Drenas çdo ditë për 24 orë.

Ketë nga dy (2) punëtorë gjatë 24 orëve. Orari i punës për punëtoret (rojet) duhet të jetë në përputhje me orarin e caktuar në Ligjin e Punës. Shpërndarja duhet të jetë: njëri roje në hyrje të parkut dhe tjetri duhet të jetë në lëvizje brenda hapësirës së Parkut.

- Mbikëqyrë rregullisht çdo detal brenda Parkut dhe të raportoj nëse vërehet ndonjë parregullsi.

- Regjistron hyrje-daljet në park.
- Njofton Agjencinë KIESA për çdo ndodhi brenda Parkut, dhe të merr masa për mbrojtjen e investimeve në Parkun e Biznesit në Drenas, si dhe të siguroj ato investime.
- Jep informacion të plotë për çdo dëmtim të pasurisë publike dhe në rast që vet është fajtor, duhet të bëjë kompensimin e cila duhet të dëshmohet me dokument të nënshkruara nga palët.
- Pranon dhe dorëzon me procesverbal të plotë punishten e parkut.
- Të jetë e përgjegjshme dhe të përgjigjet konform legjislacionit në fuqi.
- Kryej edhe punë tjera rreth sigurimit fizik të Parkut, në rast që kërkohet nga investitori.
- Bëjë mirëmbajtjen (rregullimin) dhe monitorimin e sistemit të kamerave brenda parkut të biznesit. Kjo vlen pas lëshimit në funksion të sistemit të kamerave brenda PBD-së.

Në rast që paraqiten ankesa të bazuara nga bizneset e Parkut, atëherë mund të merren masa për ndërprerjen e njëanshme të kontratës.

- Në rast që Parku i Biznesit jepet në shfrytëzim apo mirëmbajtje afatgjatë, si p.sh. më modelin e PPP-së, atëherë kontrata në fjalë ndërprehet dhe pagesa bëhet deri me datën e vendimit kur është ndërprerë kontrata.

Sqarim:

1. Shpërndarja e punëtorëve (rojeve) duhet të bëhet në koordinim me autoritetin kontraktues, përcaktimi i pikave, i numrit, i shpërndarjes së rojeve...etj.

2. Numri i Objekteve dhe/ose numri i rojeve mund të rritet apo të zvogëlohet, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktues që mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

3. Numri i përafërt i punëtorëve (rojeve) do të jetë rreth njëzet (28) persona (OE duhet të na dëshmojë kontratat e punës si dhe vërtetimin nga ATK që paguan taksat dhe kontributet për punëtoret).

4. Objekti i Industrisë Kimike, Parku i Biznesit në Drenas dhenë Z.K. Bërnicë e Epërme me lokacion në "Bardhosh", Prishtinë posedojnë rrethoja që nënkupton sigurimin e tyre (rrethojës) dhe hapësirave brenda tyre.

5. Orari i punës për punëtoret (rojet) duhet të jetë në përputhje me orarin e caktuar në Ligjin e Punës (40 orë pune në javë).

6. Në rast te humbjes apo vjedhjes së ndonjë gjësendi në kohen e siguruar nga ana e Kompanisë, kompania duhet te përgjigjet brenda 10 ditëve nga humbja apo vjedhja duke e kompensuar demin e shkaktuar.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është 30 %

Vërejtje: Pagat e punëtoreve nuk duhet të jenë më të ulta se 350.00.00 € neto.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

(Të jepet një vlerësim se OE ankues**është palë** me interes sipas **nenit 4.1.26 të LPP-së**

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"Internat Security Association"SH.P.K.**

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, se bazuar në analizën tonë e cila është e saktë minimum i cmimit të ofertuesve në këtë rast vetëm duke llogaritur pagat e kërkuara do të duhej të ishte në pragun e cmimit me TVSH **320855.40** euro, cmimi I ofertës sonë **339,009.00 euro mbi pragun e lejuar** , ku janë kalkuluar pagat dhe zavendesimet për pushime vjetore, atëherë si është e mundur që OE I shpallur fitues të mbulojë kërkesën e juaj financiare, kjo është diskriminuese dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimit pasi që keni bërë shkelje të kushteve për pjesmarrje në tender të OE ofertues e posaqërisht keni bërë shkelje të nenit 7 , neni 27 , nenit 59 të LPP- së. OE I shpallur fitues wshtw me ofertw afwr 20000.00 euro nën paga.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, si dhe bazuar ne specifikat teknike te detyrushme – Aneksi 1 te FDT-së, po jap sqarime si në vijim:

ANALIZA E ÇMIMEVE/PAGAVE

I. Paga bruto, neto dhe kontributet për një punëtor

Punëtori	Paga bruto (a)	Kontributi i punëdhënsit për skemen e pensionit (b)	Kontributi i punesuarit per skemen e pensionit (c)	Të ardhurat e tatushme (d)	Tatimi i mbajtur ne burim (e)	Pagat e paguara pas tatimit - Neto ne €uro (f)
1	385.36	19.27	19.27	366.09	16.09	350.00

II. Pagat me te gjitha kontributet e aplikushme në Republiken e Kosovë

Numri i punëtoreve (a)	Paga bruto (€) (b)	Shuma e pagave bruto (€) (c)	Kontributi i punedhnesit per pension per një punëtore (€) (d)	Shuma e kontributeve te punedhensit (€) (e)	Gjithesejt pagat me te gjitha taksat e aplikuara ne Kosoves (€) (f)	
28	385.36	10790.08	19.27	539.56	€	11329.64
				Totali i pagave	€	**11329.64**
					Muaj	24
					Totali	**271911.36**
					TVSH 18%	**0.18**
				Totali i TVSH		**48944.04**
				Totali i përgjithshem me TVSH		**320855.40**

Vëmendje/sqarim:

385.36	19.27	404.63
0.18		0.18
69.36		72.83
454.72		477.46
12732.29		13368.98
24		24
305575.07		**320855.40**

III. Shpenzimet operacional	**0.00**	**24.00**	**0 €**
IV. Fitimi i kompanisë			
Fitimi :	**0.00**	**24.00**	**0.00**
V. Pushimet vjetore, mjekësore etj	**0.00**	**24.00**	**0.00**

Llogaritja e cmimit perfundimtare të ofertes: II+III+IV+V+TVSH

II	**11329.64**	**II**	**271911.36**
III	**0 €**	**III**	**0 €**
IV	**0.00**	**IV**	**0.00 €**
V	**0.00**	**V**	**0.00**
	11329.64		**271911.36**
			48944.04
	0.18		**320855.40**
	2039.34		
	13368.98	**Analiza nga Eksperti shqyrtues**	
	13368.98		
	24		
	320855.40		

Po ashtu, **eksperti shqyrtues sqaron** se bazuar në aneksin 1 të FDT-së, të përcaktuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku janë specifikuar numri i përafërt i punëtorëve, paga neto, Ligji i Punës etj...., ku parashihen edhe pushimet vjetore dhe mjekësore si dhe fitimi që mund të rrjedhë nga ky aktivitet i prokurimit, dhe qe eshte dashur te vlerësohen/analizohen dhe te konstatohet ne raport nga komisoni i vlerësimit, andaj konsideroj se AK – komisioni i vlerësimit ka vepruar ne kundërshtim me **nenin 7 par. 2 të LPP-së**, ku thotë: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*", po ashtu marrë për bazë se AK – ZPP në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk është lëshuar ne pretendimet e OE ankues me arsytimin se OE ankues është palë pa interse ne këtë aktivitet të prokurimit, (andaj konsideroj se fillimisht duhet të trajtohen nga AK) nuk është i arsytuar për faktin se AK – komisioni i vlerësimit dhe B058 njoftimi mbi vendimin e AK / letrat standarde OE i cili është me çmim më të lartë se sa OE i rekomanduar për dhënie të kontrates është eleminuar /shpallur OE i pa përgjegjshëm, andaj është duashur të trajntohen nga AK.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, **nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit– ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore të LPP-së, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, (*për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë*) dhe rekomandon që të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"Internat Security Association"SH.P.K.**

Sahit Beqiri

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TEMA RAZMATRANJE NABAVIKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA